

V E N D I M
Nr.299, datë 4.7.1994

**PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË SISTEMIT TË REGJISTRIMIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME (SRPP) DHE SIGURIMIN E MJEDISEVE TË REGJISTRIMIT**

Më propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Njësia e menaxhimit të projektit (NMP) për sistemin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme (SRPP), në bashkëpunim me seksionet e kadastrës dhe urbanistikën në rreth dhe me kadastrën urbane të Bashkisë së Tiranës emëron koordinatorin e saj, i cili organizon dhe drejton punën për sistemin e regjistrimit të të gjitha pasurive të paluajtshme.

2. Pagesa e këtyre punonjësve bëhet nga njësia e menaxhimit të projektit (NMP) sipas kontratës individuale të punës.

3. Fondi i pagave të planifikuara nga këshilli i rrethit, që sot për sot merret nga këta punonjës, të përdoret për pajisje dhe meremetime të zyrave të kadastrës së rrethit.

4. Specialistët e tjerë që nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin e që do të punojnë për realizimin e projektit, të paguhen nga NMP-ja sipas vëllimit të punës, në bazë të kontratës individuale të punës.

5. Dokumentacionet e pronësisë, të përcaktuara sipas ligjeve nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre, që sot për sot administrohen nga kadastrat bujqësore, urbane, hipotekat dhe ndërmarrjet komunale të banesave, të vihen gradualisht sipas kërkesës në dispozicion të koordinatorëve të projektit në rreth.

6. Këshillat e rretheve, në bashkëpunim me këshillat e bashkive dhe me Bashkinë për qytetin e Tiranës, të sigurojnë brenda muajit korrik të vitit 1994 mjediset e nevojshme prej 300 m² për zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, të cilat do të jenë bazat e unifikimit të zyrave të sotme të kadastrës dhe të hipotekës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi